



Udhëzues mbi modelin e të hyrave dhe tarifave (RTM)

2008

DEKLARATË

Ky udhëzues është pregatitur vetëm për qëllime informative. Asgjë që përfshihet Brenda udhëzuesit mbi modelin e të hyrave dhe tarifave nuk duhet të konsiderohet se përfaqëson vendim të ZRRE-së përveç nëse nuk është shpjeguar qartazi e kundërta.

Përmbajtja

1	Hyrje	Error! Bookmark not defined.
2	Struktura e modelit	1
3	Futja e të dhënave	Error! Bookmark not defined.
4	Modulet rezultuese	5
5	Modulet hyrëse	Error! Bookmark not defined.
5.1	Paqyra fizike e të hyrave	5
5.2	Paqyra e kostos së të hyrave	Error! Bookmark not defined.
5.3	Pasqyra e bilansit të Energjisë	Error! Bookmark not defined.
5.4	Pasqyra e kostos energjetike	Error! Bookmark not defined.
6	Moduli i të hyrave të lejuara	Error! Bookmark not defined.
7	Moduli i tarifave	Error! Bookmark not defined.
7.1	Pasqyra <i>LRMC</i>	Error! Bookmark not defined.
7.2	Pasqyra <i>LAF (FPH)</i>	Error! Bookmark not defined.
7.3	Pasqyra e <i>Faktorit përshtatës</i>	13
7.4	Pasqyra e TUOS ngarkesave (Përdorimi transmissiv i sistemit)	Error! Bookmark not defined.
8	Moduli Financiar	13
8.1	Pasqyra e të hyrave dhe kostos së KEK-ut	14
8.2	Pasqyra e të hyrave dhe kostove të KOSTT-it	14
8.3	Pasqyra e TVSH-së	Error! Bookmark not defined.
8.4	Pasqyra e Financave	Error! Bookmark not defined.
Shtojca 1: Kalkulimi i të hyrave të lejuara në RTM		15
Kalkulimi i kostos së lejuar		15
Qasja e përgjithshme		Error! Bookmark not defined.
Kostoja e furnizimit me pakicë		Error! Bookmark not defined.
Kostoja e blerjes së energjisë		Error! Bookmark not defined.

Table of Contents

Humbjet	Error! Bookmark not defined.
Shërbimet ndihmëse	Error! Bookmark not defined.
Alokimi i kostos së Zyrës kryesore	Error! Bookmark not defined.
Konvertimi ndaj të hyrave të lejuara	Error! Bookmark not defined.
Aktivitetet jo-rregullatore	Error! Bookmark not defined.
Korrigjimet dhe përshtatjet kompenzatore	Error! Bookmark not defined.
Shtojca 2: Kalkulimi i Tarifave në RTM	19
Struktura e tarifave me pakicë	Error! Bookmark not defined.
Kalkulimi i tarifave me pakicë	Error! Bookmark not defined.
Ngarkesat e konsumatorëve/fikse	Error! Bookmark not defined.
Ngarkesat e kërkesës	Error! Bookmark not defined.
Ngarkesat e Energjisë	Error! Bookmark not defined.
Ngarkesat e energjisë reaktive	Error! Bookmark not defined.
Kalkulimi i ngarkesave të TUOS	Error! Bookmark not defined.
Kalkulimi i ngarkesave të DUOS (Përdorimi distributiv i sistemit)	Error! Bookmark not defined.

1 Hyrje

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) ka zhvilluar një model të të hyrave dhe tarifave (RTM) për të asistuar ate në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave të lidhura me rishikimin e çmimeve (të përdorura për të përcaktuar të hyrat e lejuara) sidhe tarifave të propozuara të rregulluara për kompanitë energjetike në Kosovë. Ky udhëzues shpjegon qëllimin e secilit modul dhe identifikon kontrollat dhe inputet e përdoruesit. Dy shtojcat ofrojnë detaje shtesë se si RTM përcakton të hyrat e lejuara dhe nivelin përkatës sidhe strukturën e tarifave të lejuara.

2 Struktura e Modelit

RTM përbëhet prej një numri të faqeve të cilat mund të grupohen në modulet pasuese:

Moduli	Titulli I Pasqyrës	Qëllimi
	Ballina	n/a
Rezultantet	Publikimi me pakicë	Tarifave të kalkuluar me pakicë për publikim
(Pasqyrat tabelare ngjyre pembe)	DUOSPublikimi	Shfrytëzimi I kalkuluar I distribucionit të ngarkesave të sistemit (DUOS) për publikim ¹
	TUOSPublikimi	Shfrytëzimi I kalkuluar I transmisionit të ngarkesave të sistemit (TUOS) për publikim ²
	Analiza	Analiza e ndryshimeve në tarifave mesatare dhe faturat shtëpijake sipas tarifave të kalkuluar.
	Përmbledhje	Krahasimi I të hyrave të lejuara sipas tarifave të kalkuluar gjatë viteve paraprake dhe propozimeve
	SNK-P&H	Deklaratat e profiteve dhe humbjeve te parapara për KEK-un dhe KOSTT-in sipas tarifave të kalkuluar në format te Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IAS)
	SNK-BGJ	Pasqyrat e bilanceve të parapara për KEK-un dhe KOSTT-in sipas tarifave të kalkuluar në format te Standardeve Ndërkombëtare të

¹ Aktualisht këto nuk janë dalluar dhe publikuar ndaras. Megjithate, atëherë kur definicioni I kualifikueshmërisë është zgjeruar për të përfshirë edhe konsumatorët e lidhur me distribucionin do të bëhet e nevojshme për të përcaktuar DUOS ngarkesat e ndara.

² Aktualisht këto nuk janë dalluar dhe publikuar ndaras. Megjithate, atëherë kur definicioni I kualifikueshmërisë është zgjeruar për të përfshirë edhe konsumatorët e lidhur me distribucionin do të bëhet e nevojshme për të përcaktuar DUOS ngarkesat e ndara.

Struktura e Modelit

Moduli	Titulli I Pasqyrës	Qëllimi
		Kontabilitetit (IAS)
	Rrjedhja e parasë - IAS	Pasqyrat e rrjedhjes së parasë së gatshme të parapara për KEK-un dhe KOSTT-in sipas tarifave të përlogaritura në formatin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IAS)
Inputet	Inputi fizik	Supozimet mbi inputet dhe të dhënat mbi parametrat fizik për llogaritjen e tarifave.
(Tabelat me ngjyrë hiri)	Kostoja e inputit	Supozimet mbi inputet dhe të dhënat mbi parametrat financiar për llogaritjen e tarifave.
	Bilanci I Energjisë	Supozimet mbi inputet dhe të dhënat mbi bilancin e energjisë
	Kostoja Energjetike	Supozimet mbi inputet dhe të dhënat mbi koston e blerjes së energjisë
Të hyrat e lejuara	Mihja	Inputet mbi koston kapitale dhe operative sidhe llogaritjen e koston së lejuar për punën e mihjes së KEK-ut.
(Tabela me ngjyrë të verdhë)	Gjenerimi	Inputet mbi koston kapitale dhe operative sidhe llogaritjen e koston së lejuar për punën e prodhimit të KEK-ut.
	Distr.	Inputet mbi koston kapitale dhe operative sidhe llogaritjen e koston së lejuar për punën distributive të KEK-ut.
	Furnizimi	Inputet mbi koston kapitale dhe operative sidhe llogaritjen e koston së lejuar për punën e furnizimit me pakicë të KEK-ut.
	Drejtoria Qendrore	Inputet mbi koston kapitale dhe operative sidhe llogaritjen e koston së lejuar për Drejtorinë Qendrore të KEK-ut. Këto kosto janë alokuar mes divizioneve të KEK-ut proporcionalisht me pjesën e përgjithshme të stafit jashtë drejtorisë qendrore të KEK-ut.
	KOSTT-i	Inputet mbi koston kapitale dhe operative sidhe llogaritjen e koston së lejuar për KOSTT.
Tarifat	Mediumi – Tariffat	Rideklarimi I kostove të lejuara në formatin e përshtatshëm për llogaritjen e tarifave të lejuara.
(Tabelat me ngjyrë të kaltërt)	LRMC	Llogaritja e koston margjinale finale (LRMC) në secilin nivel distributiv të voltazhës (të përdorur në llogaritjen e DUOS ngarkesave)
	LAF	Llogaritja e faktorëve pershtates të humbjes (LAF) në çdo nivel të voltazhës (I përdorur në llogaritjen e TUOS dhe DUOS ngarkesave)
	Faktorët alokues	Alokimi I energjisë, kërkesës dhe koston e varura nga konsumatorët përmes kategorive tarifore (duke përdorur inputet nga Pasqyra e inputeve fizike).
	Alokimi I Koston	Alokimi I koston së varur nga energjia sipas sezonës (lartë/ulët) dhe periudhës ditore (lartë/ulët) (përfshirë këtu inputet nga Pasqyra e inputeve fizike).
	Tarifa me pakicë	Konvertimi I koston së alokuar në tarifa me pakicë për çdo kategori tarifore.

Struktura e Modelit

Moduli	Titulli I Pasqyrës	Qëllimi
	Bllok tarifa HH	Konvertimi I tarifës mesatare me pakicë për konsumatorët shtëpijak në bllok tarifa.
	DUOS Tarifa	Llogaritja e DUOS ngarkesave ndaras, duke përdorur kostot e alokuara
	Tarifat kosto-reflektive	Tarifat kosto-reflektive me pakicë bazuar në kostot e alokuara (të llogaritura nga pasqyrat paraprake)
	Factorët përshtatës	Përshtatjet e definuara nga përdoruesit ndaj tarifave kosto-reflektive me pakicë (psh. Për të parandaluar rritjet tej mase në tarifat individuale)
	Tarifat përshtatëse	Tarifat me pakicë të llogaritura sipas përshtatjeve të definuara nga përdoruesit.
	Shitjet	Volumi I shitjeve sipas secilës tarifë me pakicë individualisht (përfshirë inputet nga pasqyra e Inputeve fizike)
	Të hyrat	Të hyrat e kalkuluara sipas tarifave të përshtatura me pakicë
	TUOS ngarkesat	TUOS ngarkesat e llogaritura
Financiare	Mediumi – Financ	Rideklarimi I kosove të lejuara dhe të hyrave të llogaritura në format të përshtatshëm për llogaritjen e deklaratave financiare.
(pasqyra tabelare me ngjyrë të gjelbërt)	Të hyrat dhe kostot e KEK	Alokimi I kosos së lejuar të KEK-ut dhe të hyrave të llogaritura sipas kategorive të kontabilitetit
	Të hyrat dhe kostot e KOSTT	Alokimi I kosos së lejuar të KOSTT-it dhe të hyrave të llogaritura sipas kategorive të kontabilitetit.
	Kontrol.Financ.	Rikontrollimi se a përshtaten kostot dhe të hyrat e alokuara me ato të lejuara dhe llogaritura.
	TVSH	Llogaritja e detyrimeve të TVSH-së për qëllim të prezentimit të llogarive financiare.
	Financimi	Llogaritja e detyrimeve te borxhit sipas kërkesave të supozuara të huazimit
	P&H-klasike	Deklarimet e profitit & humbjeve(të hyrave) të parapara për KEK-un dhe KOSTT-in sipas tarifave të kalkuluara, në format klasik
	PB-klasike	Pasqyrat e parapara të Bilancit për KEK dhe KOSTT sipas tarifave të llogaritura, në format klasik.
	Rrjedh.parase-klasike	Deklaratat e rrjedhjes së paraparë të parasë për KEK dhe KOSTT sipas tarifave të llogaritura në format klasik.

Modeli kërkon që të dhënat duhet të futen për secilin për viteve pasuese (ku T është Viti Tarifor që rishikohet momentalisht³):

³ Psh. Nëse tarifat janë duke u përcaktuar për vitin tarifor 2008, atëherë T=2008, T-1 = 2007 dhe T+1 = 2009

- **T-2 aktual**-kjo përfaqëson shitjet aktuale, kostot dhe të hyrat nga viti paraprak tarifor përveq njëjës. Është përdorur si kontrollim mbi arsyeshmërinë e kostove të paraqitura nga kompanitë energjetike.

T-1 I lejuar— Përfaqëson shitjet e parapara dhe kostot e lejuara sidhe tarifatat siq përcaktohen nga ZRRE-ja nga viti paraprak tarifor. Kjo lejon identifikimin e ndryshimeve të mëdha nga vlerat e lejuara paraprakisht të cilat mund të kërkojnë një hetim të mëtejshëm.

- **T-1 aktual**—Përfaqëson shitjet aktuale, kostot dhe të hyrat e vitit tarifor paraprak⁴. Ajo përdoret si një kontrollim mbi arsyeshmërinë e kostove të paraqitura nga kompanitë energjetike.

T e kërkuar— Përfaqëson koston dhe tarifatat e paraqitura nga kompanitë energjetike për vitin tarifor ashtu siq janë amenduar nga ZRRE-ja në bazë të analizës.

T+1 indikative— Kjo përfaqëson vlerësimet indikative të shitjeve, kostove dhe të hyrave në vitin vijues tarifor. Për rishikimet vjetore të çmimeve, kjo është përdorur për të lejuar analizat e trendeve më afatgjata dhe çfardo implikimi nga vendimet mbi kostot e lejuara në vitin aktual ose vitet e ardhshme (i.e. nga shtyrja e shpenzimeve kapitale).Për rishikimet trivjeçare të çmimeve (aty ku normat e bazuara në performancë janë aplikuar), ky është përdorur për të futur kostot e paraqitura për vitin e mesëm të periudhës trivjeçare.

- **T+2 indikative**— Kjo përfaqëson vlerësimet indikative të shitjeve, kostove dhe të hyrave në vitin vijues tarifor. Për rishikimet vjetore të çmimeve kjo është joaktive dhe për këtë futen të dhënat fillestare ('default') (aktualisht, kjo është caktuar barazi me vlerat e vitit paraprak).Për rishikimet e çmimeve trivjeçare (aty ku aplikohen normat e bazuara në performancë) kjo është përdorur për të futur kostot e paraqitura për vitin e fundit nga periudha trivjeçare.

FUTJA E TË DHËNAVE

Futja e të dhënave është e koduar me ngjyra. Fillimisht, të dhënat duhet të futen vetëm në katrotët e **pahijezuar**. Të dhënat e futura nga KEK-u dhe KOSTT-I duhet mëpastaj të kodohen veçmas për të mundësuar që ato të dallohen nga të dhënat e futura nga ZRRE-ja. Të dhënat e KEK-ut duhet të kodohen me katrorë me ngjyrë të **gjelber** kurse ato të KOSTT-it me katrorë të **kaltër**. Pjesët e

⁴ Aty ku fillon viti tarifor me 1 Janar atëherë të dhënat do të jenë të disponueshme vetëm për nëntë muajt e parë të secilit vit kurse tre muajt e mbetur duhet të vlerësohen.

mëposhtme përmbledhin të dhënat kryesore të definuara nga përdoruesi sipas secilit modul dhe pasqyrë.

3 Moduli I rezultanteve

Ky modul ofron raporte të ndryshme në format të përshtatshëm për publikim nga ZRRE-ja. Për dallim nga modulet tjerë, katrorët e **pahijezuar** nuk indikojnë lokacionet e futjes së të dhënave-ato janë lënë të pahijezuara për ti bërë të përshtatshme për kopjim dhe bartje në shkresat consultative sidhe dokumentacionin tjetër të ZRRE-së. Asnjë e dhënë nuk duhet të futet në këto pasqyra.

4 Moduli I Inputeve

Moduli I inputeve është përdorur për të future supozimet kryesore dhe të dhënat e përdorura për qëllimet e llogaritjes së të hyrave të lejuara dhe tarifave (alokimin e kostos në veçanti)

4.1 Pasqyra e Inputit Fizik

Kjo pasqyrë tabelare është përdorur për të futur të dhënat kryesore mbi shitjet nga konsumatori dhe lloji I ngarkesës I cili në anën tjetër është përdorur për të alokuar kostot e lejuara mes kategorive të konsumatorëve dhe tarifave dhe për të llogaritur shitjet dhe të hyrat sipas tarifave rezultuese.

Kategoria	Të dhënat	Përmbajtja
Viti bazë		Kjo përcakton T-1 (shih me lartë)
Kërkesa	Kërkesa koiciduese	Kërkesa e atribuar secilës kategori të konsumatorëve sipas secilit nivel të voltazhës në kohën gjatë pikut të kërkesës së sistemit vjetor
	Kohëzgjatja e ngarkesës	Numri I orëve të kërkuara për secilën kategori të konsumatorëve, nëse konsumojnë gjatë pik kërkesës koiciduese për çdo orë për të arritur konsumin vjetor total (psh, nëse pik kërkesa koiciduese është 100MË dhe konsumi vjetor është 100GWh atëherë kohëzgjatja e ngarkesës do të ishte 1,000 orë = 100GWh / 100 MW)
	Kërkesa që ngarkohet (për tu paguar v.perkth)	Kërkesa e atribuar secilës kategori të konsumatorëve për qëllime faturimi. Ngarkesat aplikohen gjate pik kërkesës jo-koiciduese të regjistruar në çdo muaj gjë që mund të jetë më e madhe se pik kërkesa koiciduese (kërkesa gjatë pikut të sistemit) Nivelet e pike kërkesës gjithashtu do të ndryshojnë nga muaji në muaj. Megjithate kjo nuk është e njejta pik kërkesë koiciduese t* 12 muaj
Konsumi	Konsumi sipas kategorive	Shitjet totale sipas kategorive tarifore të konsumatorëve sipas volumit dhe përqindjes
	Konsumi sipas periudhës	Proporcioni I shitjeve të energjisë sipas kategorive të konsumatorëve brenda secilës nga katër periudhat e ngarkesave (të ulët dhe të larta /dimrit dhe të ulëta dhe të larta/verës)

Moduli I Inputeve

Kategoria	Të dhënat	Përmbajtja
	Konsumi sipas bllokut	Proporcioni I shitjeve shtëpijake të energjisë gjatë çdo blloku tarifor. Nëse nje tarifë e veçantë nuk është llogaritur për rastet sociale, atëherë shitja në atë bllok duhet të vihet në zero ⁵
Konsumatorët	Numrat e konsumatorëve	Numri I konsumatorëve sipas secilës kategori (mesatarja vjetore)
	Konsumatorët pa njehësor	Numri I konsumatorëve shtëpijak pa njehësor të alokuar ndaj secilit bllok tarifor
	Faktori I ponderuar I alokimit të konsumatorit	Kostoja e njehësimit, faturimit dhe inkasimit (MBC)për secilën kategori të konsumatorëve të lidhura me ato të konsumatorëve shtëpijak më njehësor 2-normësh (kategoria e 5te e konsumatorëve). Për shembull, një koeficient 6 nënkupton se kostoja MBC të një kategorie konsumatorësh është 6 herë ajo e konsumatorëve të kategorisë së 5-të dhe si rezultat, proporcioni i ngarkesave të lidhura me konsumatorë të alokuara atyre duhet të jetë 6 herë më I madh.
Energjia Reaktive ⁶	Energjia reaktive e matur	Sasia totale e shitjes së energjisë së matur reaktive sipas secilit nivel të voltazhës.
	Alokimi i kosos së energjisë reaktive	Pasqyra e kosos totale të energjisë reaktive e ndarë sipas n iveleve të voltazhës (aktualisht proporcionale me shitjet e njehësuar)
	Alokimi i kosos së energjisë reaktive mes kategorive të konsumatorëve	Pjesa e kosos së energjisë reaktive sipas secilit nivel të voltazhës alokuar secilës kategori të konsumatorëve (psh. 100% të kosos së energjisë reaktive të alokuar nivelit 10kV në anën tjetër I janë alokuar kategorisë 3 të konsumatorëve- 0.4kV komercial me njehësor të energjisë reaktive).
Të dhënat e rrjetit	Humbjet e rrjetit	Sasia e energjisë së humbur mes hyrjes dhe daljes nga secili nivel I voltazhës. Kjo është përdorur për humbjet vetëm mes kategorive të konsumatorëve dhe mund të mos përputhet me humbjet e lejuara të paraqitura në pasqyrën tabelare të Bilancit të Energjisë.
	Proporcioni i kërkesës prej 10 kV që kalon nëpër rrjetin 35 kV	Ky është proporcioni I supozuar I kërkesës në rrjetin 10kV që furnizohet përmes rrjetit 35 kV në vend se direkt nga ai 100kV (transmisionit). Ky është përdorur për të atribuuar një pjesë të kosos së rrjetit 35kV ndaj konsumatorëve të lidhur në ate prej 10kV ose edhe më të ulët.

⁵. Aty ku subvencioni I rasteve sociale paguhet drejtpërdrejt nga Qeveria, nuk ka nevojë që të krijohen blloqe të ndara tarifore për këta konsumatorë. Ata faturohen normalisht por faturat e tyre paguhen nga qeveria.

⁶ Aktualisht, për shkak të brengosjes për përshtatshmërinë e provizioneve të alokimit të kosos së energjisë reaktive në RTM, këto të dhëna nuk janë përdorur për të përcaktuar ngarkesat e energjisë reaktive. Ngarkesat për energjinë reaktive janë futur nga jashtë në pasqyrën tabelare të Kosos së Inputeve (InputCost).

4.2 Pasqyra tabelare e inputit të Kostos (InputCost)

Kjo pasqyrë tabelare është përdorur për të futur të dhënat jo-fizike të përdorura për qëllim të alokimit të kostove mes kategorive dhe tarifave të konsumatorëve.

Kategoria	Të dhënat	Përmbajtja
Pjesa e të hyrave të lejuara	Kostoja e kapacitetit si përqindje e kostove totale	Kjo përfaqëson një pjesë të supozuar të kostos së kapacitetit në kostot e blerjes së energjisë totale me shumicë (gjenerimin+importin). Mëtej kjo përdoret për të alokuar këto kosto mes ngarkesave të energjisë dhe kërkesës. Vlerat aktuale janë caktuar gjatë ETR1.
SRMC-ja e përshtatur të hyrave		Kjo përcakton koston e supozuar marginale (SRMC) të furnizimit me shumicë me energji sipas secilës periudhë tarifore ⁷ . Kjo është caktuar si mesatarja e kostos variabile të furnizuesit marginal (njësive gjeneruese ose importeve) në secilën orë të periudhës tarifore. Llogaritja është bërë sipas ETR1 dhe është mbajtur e pandryshuar për ETR2
Faktorët përshtatës të kërkesës së energjisë	DUOS tarifat	Kjo ndanë pjesën e varur nga kërkesa (kapaciteti) i kostos distributive mes pjesës së alokuar për ngarkesat e kërkesave dhe të alokuara për tarifat e energjisë për konsumatorët industrial dhe komercial të lidhur me distribucionin ⁸ . Futja e 100% alokon të gjitha këto kosto në ngarkesat e kërkesës, kurse futja e 0% alokon të gjitha ato në ngarkesat e energjisë, kurse vlerat ndërmjet, I alokojnë ato proporcionalisht.
	Tarifat me pakicë	Kjo lejon përdoruesin që të definojë se cila pjesë e kostove të energjisë jo-reaktive dhe jo të konsumatorëve (psh. Shitja me shumicë/e tërësishme e energjisë dhe kostot e rrjetit) I është alokuar kërkesës , e cila ngarkesave të energjisë në tarifat finale me pakicë për konsumatorët industrial dhe komercial të lidhur me distribucionin ⁹ Futja e 100% alokon të gjitha këto kosto në ngarkesat e kërkesës,

⁷ SRMC përfaqëson koston marginale të blerjes së përgjithshme/me shumicë të energjisë sipas secilës periudhë tarifore. SRMC-ja relative rrjedhimisht përfaqëson kostot relative të shitjeve të energjisë për t'iu përshtatur kërkesës në secilën periudhë dhe, në princip relativitetin që duhet të ekzistojë mes ngarkesave të energjisë (para përshtatjeve për humbjet) në secilën periudhë tarifore.

⁸ Asnjë ngarkesë e kërkesës nuk aplikohet për konsumatorët shtëpijak dhe rrjedhimisht të gjitha kostot e distribucionit të alokuara këtyre konsumatorëve janë mbuluar përmes ngarkesave të energjisë.

⁹ Asnjë ngarkesë e kërkesës nuk aplikohet ndaj konsumatorëve shtëpijak dhe si rrjedhim të gjitha kostot e alokuara këtyre konsumatorëve janë mbuluar përmes ngarkesave të energjisë.

Kategoria	Të dhënat	Përmbajtja
		kurse futja e 0% alokon të gjitha ato në ngarkesat e energjisë, kurse vlerat ndërmjet, I alokojnë ato proporcionalisht ¹⁰ . Futja >100% nënkupton se këto kosto janë alokuar në proporcionet e llogaritura brenda RTM-së.
Raportet mes periudhës tarifore të lartë dhe të ulët		Kjo I lejon përdoruesit që të imponojë një raport të tarifave të energjisë së periudhës së lartë deri te e ulëta (lart dhe ulët/dimër dhe lartë dhe ulët/verë) në vend se ti lë këto të llogariten brenda RTM-së (në proporcion me kostot relative të furnizimit në secilën periudhë). Ky opcion është në dispozicion vetëm për konsumatorët më të vegjël shtëpijak dhe komercial me njëhësim dy-normësh të cilët ERAV mund të dojë ti mbrojë prej ndryshimeve të papritura në relativitetin e tarifave. Futja e vlerës 0 nënkupton që tarifat relative të energjisë janë llogaritur brenda RTM-së ¹¹
Faktorët përshtatës të bllokut shtëpijak		Këto janë përdorur për të përcaktuar subvencionin e përmbajtur në tarifën e energjisë për secilin bllok (ngarkesat e konsumatorëve janë të njëjtat për të gjithë konsumatorët shtëpijak në secilën kategori) Futja e -30% psh. Nënkupton se tarifën energjetike në atë bllok janë caktuar 30% nën tarifën mesatare të energjisë për atë kategori të konsumatorëve shtëpijak, me tarifën në bllokun më të lartë që rriten në mënyrë korresponduese ashtu që të kompenzojnë në një mënyrë mungesën e të hyrave.
Normat e inkasimit	Norma e lejuar e inkasimit	Kjo është një normë e inkasimit për qëllimet e përcaktimit të kostos dhe tarifave të lejuara. Futja e 100% nënkupton se nuk lejohet asnjë mbulim I mos-inkasimeve përmes tarifave më të larta.
	Norma aktuale e inkasimit	Kjo është norma aktuale/e supozuar e inkasimit e përdorur për përgatitjen e projektimit/parashikimit financiar në RTM
Kostoja e energjisë reactive sipas pasqyrës së kostos		Kjo lejon përdoruesin që të fusë tarifën e energjisë reactive si një alternativë ndaj kësaj që llogaritet Brenda RTM-së ¹² .

¹⁰ Momentalisht, një vlerë prej 0% është futur vetëm për konsumatorët e vegjël komercial pa njëhësim të energjisë reactive (kategoria 4) për të cilët ngarkesat e kërkesës nuk janë aplikuar.

¹¹ Për momentin, vlera 2 është future për të dy kategoritë e konsumatorëve. Kjo nënkupton se relativitetet ekzistuese (aty ku tarifën e periudhës së lartë janë dy herë sa ato të periudhës së ulët korresponduese) janë mbajtur edhe aty ku RTM-ja llogarit një raport alternative si më kosto-reflektiv.

¹² Kjo është qasja aktualisht e aplikuar në mënyrë që të evitohen anomalitë që I ka shkaktuar llogaritja e RTM-së.

4.3 Pasqyra tabelare e bilancit të energjisë

Kjo pasqyrë tabelare është përdorur për të paraqitur bilancin e energjisë të përdorur në llogaritjen e kostos së blerjes së energjisë, humbjeve dhe shitjeve. Paraqitja e bilancit ka qasje të ndryshme varësisht se a janë përdorur të dhënat historike ose të parashikuara:

- Për T-2 dhe T-1, aty ku dihen blerjet e energjisë, bilanci është llogaritur në baza nga lartë-poshtë. Përdoruesi fut blerjet e energjisë (gjenerimin dhe importin), humbjet dhe shitjet ndaj konsumatorëve të lidhur me transmisionin. RTM-ja pastaj llogarit shitjet ndaj konsumatorëve të lidhur me distribucionin si reziduale.
- Për vitet e parashikuara (T deri T+2) bilanci llogaritet në baza nga poshtë-lart. Përdoruesi fut shitjet të konsumatorët e lidhur me transmisionin dhe distribicioni, humbjet dhe blerjet e energjisë nga gjeneratorët brenda Kosovës. RTM-ja pastaj llogarit blerjet nga importi si reziduale.

Kategoria	Të dhënat	Përmbajtja
Gjenerimi		Kjo është përdorur për të futur blerjet aktuale/të parashikuara nga gjeneratorët brenda Kosovës (pronë e KEK-ut dhe IPPs).
Importet dhe eksportet	Importet-tranziti	Kjo është përdorur për të futur trendet e pritura të tranzitit që hyjnë në Kosovë
	Importet-bletje nga furnizimi I KEK-ut	For earlier years (T-1 and T-2), this is directly entered as total purchases in the form of imports by KEK Supply Për vitet e mëhershme (T-1 dhe T-2) kjo është futurë direkte si shitjet totale në formë të importeve nga furnizimi I KEK-ut për të përbushur kërkesat në Kosovë. Në vitet e parashikuara (T e mëtej), është llogaritur se brenda RTM-s si reziduale të kërkuar për të balancuar furnizimin dhe kërkesën e Kosovës.
	Humbjet e tranzitit	Këto janë humbjet e supozuara të asociuara me trendet e tranzitit (të kompenzuara sipas mekanizmit të TSO-së)
	Eksportet-tranziti	Këto janë trendet e tranzitit që dalin nga Kosova, të llogaritura pasi trendi i tranzitit importon më pak humbje tranzitore.
	Eksportet-shitjet nga Furnizimi I KEK-ut	Këto janë shitjet e eksportit nga furnizimi I KEK-ut me energjisë e blerë nga gjeneratorët brenda Kosovës.
Transmisioni	Transmission Loss Factor (TLF)	Këto janë humbjet aktuale/të lejuara të transmisionit. Është llogaritur në përputhje me Rregullat e Përkohshme të Tregut ¹³ . Për

¹³ FHT-ja është llogaritur si një shumë e energjisë së matur që hyn në rrjetin e transmisionit për t'iu shërbyer kërkesës së Kosovës (gjenerimi I lidhur me transmisionin I lokalizuar brenda Kosovës plus importet neto) të pjestuara me energjinë e matur që del nga transmisioni në Kosovë (shitjet konsumatorëve të lidhur me transmision, konsumi vetanak I KEK-ut dhe hyrja në rrjetin e distribucionit). Ky definicion nënkupton që humbjet e tranzitit, të cilat nuk mund të dallohen ndaras, janë përfshirë në FHT. Kostoja e humbjeve të tranzicionit duhet që mëpastaj të mbulohet përmes mekanizmit kompenzues Inter-OST, procedimet neto të të cilit janë përdorur për të reduktuar TUOS ngarkesat e ardhshme.

Moduli i të hyrave të lejuara

Kategoria	Të dhënat	Përmbajtja
		vitet e mëhershme (t-1 dhe T-2), humbjet aktuale të transmisionit janë future (si GWh) dhe FHT është llogaritur nga këto. Për vitet e parashikuara (T e mëtej), një FHT I lejuar është futur dhe humbjet e transmisionit llogariten nga kjo.
Ngarkesa e transmisionit	Shitjet te konsumatorët e lidhur me transmisionin	Këto janë shitjet direkte konsumatorëve të lidhur me rrjetin e transmisionit (110kV e me lartë) atyre të kualifikuar dhe te pakualifikuar.
	Konsumi I KEK-ut	Kjo është përdorimi vetanak I energjisë nga KEK-u (psh. Në operacionet e mihjes) për të cilat nuk është bërë asnjë lloj pagese
Ngarkesa e distribucionit	Humbjet e distribucionit-teknike	Këto janë paraqitur si një përqindje e energjisë së përgjithshme që hyn në rrjetin e distribucionit
	Humbjet e distribucionit-jo-teknike	Këto janë shprehur si përqindje e energjisë totale që hyn në rrjetin e distribucionit. Ato përfshijnë humbjet e shkaktuara nga vjedhjet dhe faturimi I gabueshëm, por jo edhe humbjet e inkasimit
	Shitjet te konsumatorët e lidhur për distribucionin	Këto janë shitjet finale konsumatorëve të lidhur me distribucion. Për vitet e mëparshme (T-1 dhe T-2) ato janë llogaritur si reziduale

4.4 Pasqyra tabelare e kostos së Energjisë

Kjo pasqyrë tabelarë është përdorur për të future kostot e supozuara të blerjeve të përgjithshme të energjisë. Për gjenerimin e KEK-ut, këto janë llogaritur Brenda RTM-s dhe aplikuar si një çmim I supozuar I transferit intern. Kostot tjera janë future direct në RTM si një çmim mesatar për MWh.

Kostoja mesatare e ponderuar e blerjes së energjisë (WAPPC) e përdorur për llogaritjen e kostos së humbjeve të blera nga Distribucioni I KEK-ut dhe KOSTT-it ne rendin 35 duhet që përgjithsisht të jenë të barabarta më WAPPC-në e sistemit si tërësi, të llogaritur në rendin 32. Për të evituar qarkimin është e nevojshme që të kopjohet dhe bartet (si vlera) kjo WAPPC e tërë sistemit në WAPPC-në e përdorur për të llogaritur humbjet blerjet.

5 Moduli i të hyrave të lejuara

Të gjitha pasqyrat tabelare të ndryshme që llogaritin të hyrat e lejuara kanë të njejtin format. Shumë prej llogaritjeve bëhet përbrenda RTM-s të bazuar në të dhënat dhe supozimet që janë future në pasqyrat tabelare tjera. Vetëm ato pika që janë futur direkt nga përdoruesi në këto pasqyra tabelare janë përshkruar në vijim.

Kategoria	Të dhënat	Përmbajtja
Pikat e	Të punësuarit	Numri I të punësuarëve në atë division (aty ku është pjesë e KEK-ut) kjo është përdorur për të alokuar kostot e drejtorisë qendrore mes

Moduli i të hyrave të lejuara

Kategoria	Të dhënat	Përmbajtja
memorandumit		divizioneve operative.
Shpenzimet operative		Këto janë kostot operative të aprovuara/kërkuara/aktuale për secilin division dhe KOSTT-in. Këto janë pranuar nga paraqitjet e kompanive energjetike. Kostoja e blerjeve të karburantit dhe energjisë janë llogaritur Brenda RTM-së.
Shpenzimet kapitale	Shpenzimet e kapitalit të konsoliduar	Këto janë kostot operative të aprovuara/kërkuara/aktuale për secilin division dhe KOSTT-in brenda vitit. Aktualisht, shpenzimet kapitale janë shtuar në Bazën e Aseteve të Rregullatorit (RAB) në vitin në të cilin janë bërë. Kjo qasje mund të ndryshojë në të ardhmen.
	Finansimi-Grantet	Këto janë grantet aktuale/supozuara të disponueshme nga Buxheti I Konsoliduar I Kosovës (KCB) dhe donatorët për shpenzimet kapitale në secilin vit.
	Financimi-donatorët/Huatë e BKK-së	Këto janë grantet aktuale/supozuara të disponueshme nga Buxheti I Konsoliduar I Kosovës (KCB) dhe donatorët për shpenzimet kapitale në secilin vit.
	Financimi-burimet tjera	Këto janë shpenzimet e mbetura kapitale që nuk financohen nga grantet ose huatë e BKK/donatorëve dhe të cilat supozohet të financohen në mënyrë komerciale.
Zhvlerësimi dhe kthimi I lejuar	Jetëgjatësia mesatare e ponderuar e asetëve	Kjo është jetëgjatësia mesatare e ponderuar e asetëve të secilës kompani energjetike-të përdorur për të llogaritur lejimet e zhvlerësimit.
	Kostoja mesatare e ponderuar e kapitalit	Kjo është kostoja komerciale e supozuar e financimit për kompanitë energjetike.Për rishikimet vjetore të çmimeve, ajo duhet të futet si vlerë nominale. Për rishikimet shumë-vjeçare të çmimeve, ajo duhet të futet si vlerë reale dhe RAB të azhurohet me inflacion/rritje.
Conversion to allowed revenues	Shitjet e pa-rregulluara-tjerat	Këto janë të hyrat e fituara nga aktivitetet e pa-rregulluara që nuk janë llogaritur Brenda RTM's (eksportet dhe shitjet ndaj konsumatorëve të kualifikuar). Aktivitetet jo-rregullatore konsiderohen të jenë ato që nuk i nënshtrohen rregullimit të çmimeve (psh aktivitetet tjera prej atyre të lidhura me shitjen e rrymës konsumatorëve final të rregulluar).
	Subvencionet-shitjet e karburanteve dhe importet	Këto janë subvencionet e paguara nga BKK për të ndihmuar financimin e kostove të blerjes së karburanteve dhe importet. Ato janë supozuar ti paguhen furnizimit të KEK-ut.
	Subvencionet-rastet sociale	Këto janë subvencione të paguara nga BKK për të mbuluar faturat e konsumatorëve të cilësuar si raste sociale. Ato janë përfshirë vetëm

Moduli tarifor

Kategoria	Të dhënat	Përmbajtja
		për qëllime informacioni dhe nuk ndikojnë në llogaritjen e kostos së lejuar ¹⁴ .
Përshtatja		Kjo është një përshtatje e përdorur për të korrigjuar ndryshimin nga rishikimet shumë-vjeçare në ato vjetore mes ETR ₁ dhe ETR ₂ . Asaj i shtohet deduktimi (I pershtatur me interes) I të hyrave të lejuara të aplikuara në vitin e parë të kontrollës shumë-vjeçare të çmimeve të caktuar nën ETR ₁ si pjese e 'rumbullakësimit' të të hyrave të lejuara mbi atë periudhë të kontrollit të çmimeve.

6 Moduli tarifor

Brenda këtij moduli, qasjet e përdoruesit janë kërkuar në paqyrat tabelare të *LRMC*, *LAF*, Faktorevë të përshtatjes dhe TUOS ngarkesave.

6.1 Pasqyra tabelare LRMC

Brenda kësaj pasqyre tabelare, përdoruesi kërkohet që të fus të dhënat e nevojshme për të llogaritur koston margjinale përfundimtare (LRMC) të rrjetit të distribucionit në secilin nivel të voltazhës. Kjo është përdorur për të alokuar kostot e distribucionit të lidhura me kapacitetin (kërkesën) mes niveleve të voltazhës dhe kategorive të konsumatorëve.

Kategoria	Të dhënat	Përmbajtja
LRMC-ja e kaskaduar	Faktori I ko incidencës	Ko incidencia mes pik kërkesës vjetore të secilës kategori të konsumatorëve dhe asaj të procesit të distribucionit në tërësi. Psh. Faktori I ko incidencës 0.95 nënkupton se kërkesa për atë kategori të konsumatorëve në kohën e pik kërkesës së sistemit është 95 % e kërkesës maksimale vjetore për atë kategori të konsumatorëve.
Llogaritja e LRAIC-it	Jetëgjatësia mesatare e asetëve	Jetëgjatësia mesatare e asetëve për llogaritjen e një pensioni vjetor në llogaritjen e LRMC-së.
	Ngarkesa e inkrementit	Ngarkesa e inkrementit (shtesë) në secilin nivel të voltazhës së secilit vit (psh. 30 MW nënkupton pik kërkesës (ngarkesën) që është 30 MW më e lartë se në vitin paraprak).
	Investimet	Investimet e bëra brenda rrjetit të distribucionit në atë nivel të voltazhës në secilin vit. Idealisht, këto do të jenë investimet e kërkuara për të përmbushur vetëm rritjen e kërkesës. Vlera aktuale e këtyre investimeve e zbritur nga kostoja mesatare e ponderuar e kapitalit të punës së distribucionit) e pjestuar nga vlera aktuale e ngarkesës së inkrementit e shërbyer, jep koston mesatare të inkrementit final (LRAIC) në secilin nivel të voltazhës- kostoja

¹⁴ Nga perspektiva e furnizimit të KEK-ut është irelevante se a është paguar një faturë nga konsumatori ose në emër të tyre nga BKK>ajo që është me rëndësi është se fatura është paguar.

Kategoria	Të dhënat	Përmbajtja
		mesatare e investimeve të reja për njësi të ngarkesës shtesë të shërbyer/servuar.
LRMC-ja sipas nivelit të voltazhës	Kostot O & M	Kostot e supozuara vjetore të operimit dhe mirëmbajtjes së njësive (për asetet e reja). Këto janë shtuar pensionit vjetor të LRAIC për të pranuar LRMC-në në secilin nivel të voltazhës.

6.2 Pasqyra tabelare e LAF-it

Në mënyrë që të llogariten humbjet në secilin nivel të voltazhës (të përdorura në atribuimin e kostove të humbjeve nëpër kategoritë e konsumatorëve), përdoruesi kërkon që të fus humbjet (të ndara në humbje komerciale dhe teknike) dhe shitjet në secilën rrjet dhe nivel voltazhe të trafostacionit. Këto të dhëna janë futur për një vit-mostër –rrjedhimisht humbjet totale të llogaritura dhe shitjet nuk do të thotë të përputhen plotësisht me ato në pasqyrën tabelare të bilancit të Energjisë.

6.3 Pasqyra tabelare e Faktorëve të përshtatjes (AdjFactors sheet)

Kjo pasqyrë tabelare është përdorur për të lejuar përdoruesin që të modifikojë tarifën kosto-reflektive të llogaritura në RTM për të marrë parasysh objektivat dhe detyrimet tjera (psh. Një tranzicion të zgjeruar ndaj niveleve të reja tarifore ose të adresohet çështja e përballueshmërisë).

Kjo është bërë duke futur, për secilën tarifë dhe kategori të konsumatorëve, një faktor me të cilin tarifa kosto-reflektive është shumëzuar për të dhënë tarifën finale me pakicë. Futja e faktorit 1 mbanë tarifën kosto-reflektive, faktori >1 rezulton në tarifë me pakicë që tejkalon nivelin kosto-reflektiv dhe një faktor <1 një tarifë me pakicë nën nivelin kosto-reflektiv.

6.4 Pasqyra tabelare e TUOS Ngarkesave

Për të lejuar llogaritjen e TUOS ngarkesave në nivelet e voltazhës se ndryshueshme dhe ngarkesave të operatorit të sistemit (OS) sidhe operatori të tregut (OT), përdoruesi duhet të fus ndarjen e të hyrave të lejuara që nuk lidhen me OT, blerjet e shërbimeve ndihmëse ose humbjeve mes dy niveleve të voltazhës së transmisionit (400 kV dhe 220/110kV) sidhe OS. Përdoruesi gjithashtu duhet të fus të hyrat totale të lejuara të OT të cilat pastaj lejojnë llogaritjen e OS dhe ngarkesat dhe të hyrat e lejuara nga rrjeti.

7 Moduli financiar

Të dhënat e futura nga përdoruesi janë të lidhura me përcaktimin e detyrimeve të TVSH-së për llogaritjen e pasqyrave financiare dhe parakushteve të supozuara të huasë për qëllime të llogaritjes së pagesave të interesit dhe ripagesave të huasë në këto deklarata.

7.1 Pasqyra tabelare e të hyrave dhe kostove të KEK-ut (KEK Rev+Cost sheet)

Përdoruesi duhet të identifikojë se cilat të hyra të fituara nga KEK-u I nënshtrohen TVSH-së (rreshti 16:22) dhe cilat kosto I nënshtrohen TVSH-së, sidhe proporcionin e secilit paragraf te koston në të cilin TVSH-ja supozohet se duhet të ngarkohet (rreshtat 172:178).

7.2 Pasqyra tabelare e të hyravedhe kostove të KOSTT-it (KOSTT Rev+Cost sheet)

Përdoruesi duhet të identifikojë se cilat kosto I nënshtrohen TVSH-së sidhe proporcionin e secilit paragraf të koston në të cilin TVSH-ja supozohet se duhet të ngarkohet (rreshtat 49:55).

7.3 Pasqyra tabelare e TVSH-së

Përdoruesi duhet të fus normën e TVSH-së, proporcionin fillestar të koston operative që I nënshtrohet TVSH-së dhe periudhën në të cilën detyrimi I TVSH-së është I matur dhe pagesat janë bërë.

7.4 Pasqyra tabelare financiare

Përdoruesi ka nevojë që të fus edhe normën e supozuar të interesit dhe kushtet e huave në kompanitë energjetike.

Shtojca 1: Llogaritja e të hyrave të lejuara në RTM

Llogaritja e të hyrave të lejuara

Qasje e përgjithshme

Metodologjia tarifore e themeluar në principet kryesore në vijim për llogaritjen e kostove të lejuara për bizneset e rregulluara:

- Kostot e lejuara janë llogaritur sipas qasjes së “bllokut ndërtues” ku kostot e lejuara janë të barabarta me shumën e shpenzimeve operative eficiente- *shpenzimet operative (opex) + zhvlerësimi + kthimi i lejuar*.
- Zhvlerësimi dhe kthimi i lejuara janë llogaritur duke ju referuar bazës së *aseteve reguletoare (RAB)*.
- Asetet për të cilat i licencuari nuk bën asnjë kosto financiare nuk janë përfshirë në llogaritjen e kthimit të lejuar. Baza rregulatore e asetëve e përdorur për këtë llogaritje është, rrjedhimisht, e llogaritur si RAB pa vlerën e asetëve “të lira” (*RABf*). Asetet e lira janë definuar si ato asete që:
 - Janë blerë para 2006-tës dhe të cilat kanë qenë ose të trashëguara nga regjimi I para 1999-tës¹⁵ ose janë financuar nga grantet e mëpastajme që I janë vënë në dispozicion industrisë.
 - Të blera më 2006 dhe mëpastaj duke përdorur grantet e vëna në dispozicion industrisë.
- Kthimi i lejuar është llogaritur si *kosto para-taksore mesatare e ponderuar e kapitalit (ĒACC) * RABf*. ĒACC-ja e përdorur për këto qëllime përfaqëson vlerësimin e ZRRE-së për kostot financiare të një biznesi efikas, në vend se kostot aktuale financiare të të licencuarit.
- Të gjitha asetet në RAB janë përfshirë në llogaritjen e zhvlerësimit të lejuar. Për këtë qëllim është aplikuar *një mesatare e ponderuar e jetëgjatësisë së mbetur të asetëve*. Kjo është llogaritur nga llogaritë statutoare.

¹⁵ Nëse sipas negociatave për statusin final, të licencuarve u është kërkuar që ose të bëjnë pagesa kompenzuese për këto asete ose supozojnë një pjesë të të gjitha huave ekzistuese të përdorura për qëllime të blerjes së këtyre asetëve, atëherë ZRRE-ja është e angazhuar që të lejojë një pjesë përkatëse të këtyre kostove të përfshihet në të hyrat e lejuara për tu mbuluar nga tarifat e rregulluara.

Shtojca 1: Llogaritja e të hyrave të lejuara në RTM

- Shpenzimet efiçente kapitale të lejuara (capex) I janë shtuar RAB-së në vitin në të cilin janë bërë¹⁶.

Kostoja e furnizimit me pakicë

Përrjashtim nga një qasje e tillë është llogaritja e kostove të lejuara (blerja jo-energjiqe) të furnizimit të KEK-ut. Kostot e këtij biznesi janë llogaritur si:

- *Kosto me pakicë* e shprehur si një kosto për konsumatorët, për të kompensuar për kostot e menaxhimit të llogarive të konsumatorëve të supozuara nga furnizimi I KEK-ut.
- *Margjinë e furnizimit* e shprehur në përqindje të kostos së blerjes së energjisë që kalon deri të konsumatorët e rregulluar për të kompensuar për rreziqet e tregut te supozuara nga furnizimi I KEK-ut dhe nevojat e kapitalit te saj punues.

Borxhet e kqija nuk janë konsideruar si kosto legjitime e furnizimit të KEK-ut dhe nuk janë përfshirë në kostot e lejuara për këtë biznes.

Kostot e blerjes së energjisë

Kostot e lejuara të blerjes së energjisë të furnizimit të KEK-ut janë llogaritur si :

- Kosto të lejuara për mihjen e KEK-ut të llogaritura si më sipër

plus

- Kostot e lejuara të gjenerimit të KEK-ut, të llogaritura si më sipër (duke përrjashtuar kostot e blerjes së karburantit nga mihja e KEK-ut)

plus

- Kostot e parashikuara te importit të energjisë

plus

- Kostot e lejuara për blerjet e shërbimeve ndihmëse nga KOSTT-i

minus

- Kostot e lejuara të humbjeve të paguara nga KOSTTi dhe Distribucioni I KEK-ut

¹⁶ Për qëllime të llogaritjes së zhvlerësimit të lejuar dhe kthimit të lejuar, është përdorur mesatarja e hapjes dhe mbylljes së RAB-së për vitin.

Shtojca 1: Llogaritja e të hyrave të lejuara në RTM

Humbjet

Distribucioni I KOSTT-it dhe KEK-ut janë respektivisht përgjegjës për blerjen e humbjeve të bërë nga transmissioni¹⁷ dhe distribucioni I energjisë. Për këtë qëllim, humbjet e distribucionit janë definuar si diferenca me rrymës elektrike të matur që hyn dhe del nga rrjeti I distribucionit (.i.e. përfshirë vjedhjen dhe humbjet tjera komerciale).

Kostot e lejuara për distribucionin e KOSTT-it dhe KEK-ut përfshijnë një provision/dispozitë për blerjen e humbjeve. Ajo është llogaritur si *çmimi mesatar I ponderuar I blerjes së energjisë* që hyn në normën e lejuar të humbjes së rrjetit* (e shprehur në përqindje).

Shërbimet ndihmëse

Kostoja e parashikuar e shërbimeve ndihmëse është përfshirë në kostot e lejuara të KOSTT-it.

Alokimi I kostove të Zyres Qendrore

Kostot e zyres kryesore të KEK-ut janë llogaritur në të njëjtën mënyrë si ato për bizneset tjera. Këto tani janë alokuar rreth bizneseve individuale në proporcion me pjesën e numrave të stafit në secilin biznes/punë.

Konvertimi në të hyrat e lejuara

Aktivitetet jo-rregullatore

Konvertimi I kostove të lejuara në të hyra të lejuara përfshinë deduktimin e të hyrave të parapara nga aktivitetet jo-rregullatore nga kostot e lejuara për secilin biznes:

- Të hyrat e parashikuara nga shitja e linjtit ndaj konsumatorëve përpos gjenerimit të KEK-ut të deduktuar nga kostot e lejuara të mihjes së KEK-ut të përfshira në kostot e lejuara të blerjes së energjisë nga furnizimi I KEK-ut.
- Të hyrat e parashikuara nga eksportet e energjisë dhe nga shitjet e energjisë konsumatorëve të kualifikuar janë deduktuar nga kostot e lejuara të blerjes së energjisë nga furnizimi I KEK-ut.
- Të hyrat e parashikuara nga kompensimi prej mekanizmit inter-OTS (ITC) janë deduktuar nga kostot e lejuara të KOSTT-it.
- Të hyrat e parashikuara prej ngarkesave të transmissioinit dhe distribucionit të paguara nga konsumatorët e kualifikuar janë deduktuar nga kostot e lejuara respektivisht të distribucionit të KEK-ut dhe KOSTT-it.

¹⁷ Përfshirë humbjet tranzite

Shtojca 1: Llogaritja e të hyrave të lejuara në RTM

- Të hyrat e parashikuara nga ngarkesat e lidhjes (aty ku këto janë përdorur për të financuar asetet e reja të rrjetit) janë deduktuar nga kostot e lejuara të distribucionit të KOSTT-it dhe KEK-ut ashtu si duhet.
- Subvencionet operative (psh. Përrjashtimi I granteve për shpenzime kapitale) të paguara nga KOSTT-i dhe KEK-u nga Buxheti I Konsoliduar i Kosovës (BKK) janë deduktuar nga kostot e lejuara për biznesin përkatës.

Korrigjimet dhe përshtatjet kompenzuese

Të hyrat e lejuara janë gjithashtu përshtatur për:

- Nënshpenzimet mbi capex-in e lejuar në periudhën paraprake, ku investimi I asocijuar nuk është bërë dhe nuk është përfshirë në investimet e planifikuara gjatë periudhës së ardhme. Aty ku investimi është ende I planifikuar, atëherë asnjë korrigjim nuk është bërë, mirpo një lejim shtesë I capex-it është dhënë.
- Dallimet mes të hyrave të parashikuara dhe aktuale dhe kostovë në periudhën paraprake që janë jashtë kontrollit të të licencuarve. Këto përshtatje përfshijnë:
 - Dallimet në kostot e blerjes së humbjeve nga Distribucioni i KOSTT-it dhe KEK-ut që rezultojnë nga dallimet mes çmimeve të parashikuara të blerjes së energjisë dhe atyre aktuale sidhe energjisë së transportuar (por jo për shkak të dallimeve mes normave aktuale dhe atyre të lejuara të humbjeve).
 - Dallimet mes të hyrave neto të parashikuara dhe atyre aktuale të KOSTT-it nën mekanizmin e ITC-së.
 - Dallimet mes subvencioneve operative aktuale dhe të parashikuara të paguara KOSTT-it dhe KEK-ut nga BKK-ja. Dallimi ju është shtuar të hyrave të lejuara.
 - Dallimet mes financimit përmes granteve aktuale dhe të parashikuara për investimet e reja të paguara KOSTT-it dhe KEK-ut nga BKK-ja. Dallimi është konvertuar nga asetet e lira të supozuara në një asset të kualifikuar për të fituar një kthim.

Në secilin rast, dallimi është shumëzuar me një plus normën një-vjeçare të huazimit të ngarkuar nga bankat komerciale në Kosovë. Kjo reflekton supozimin se i licencuari ose duhet që të huazojë për të kompenzuar mungesat në të hyrat e lejuara që janë jashtë kontrollit të tij, ose mund të depozitojë suficitin dhe pranojë një kthim të këtyre.

Shtojca 2: Llogaritja e tarifave në RTM

Struktura e tarifave me pakicë

Tarifat me pakicë të rrymës elektrike në Kosovë përmbajnë:

- Ngarkesat fikse ose të konsumatorëve (të shprehura në €/konsumator/muaj). Këto janë përdorur për të mbuluar kostot e furnizimit të lidhura me konsumatorin.
- Ngarkesat e kërkesës, për konsumatorët me matje përkatëse (të shprehura në €/kW dhe të aplikuar në pik kërkesën e matur secilin muaj). Këto janë përdorur për të mbuluar ato kosto (fikse) të furnizimit të bëra nga pik kërkesa (psh. Ofrimi I rrjeteve dhe kapaciteteve gjeneruese)
- Ngarkesat e energjisë (të shprehura në €/kWh, me norma të ndryshme të aplikuar në sezonat e larta dhe të ulëta dhe kohë të ditës). Këto janë përdorur për të mbuluar kostot variabile të furnizimit (psh. Kostot e karburantit të gjenerimit dhe kostot e energjisë importuese).
- Ngarkesat e energjisë reaktive, për konsumatorët më të mëdhenjë me matje përkatëse (të shprehur në €/kVArh). Këto janë përdorur për të mbuluar kostot e ofrimit të energjisë reaktive.

Llogaritja e tarifave me pakicë

Qasja e përgjithshme është për të alokuar të hyrat e lejuara në kostot e lidhura me konsumatorin, lidhura me kërkesën dhe energjinë varësisht nga faktori primar i koston. Këto kosto janë mëpastaj të alokuara me kategorive individuale tarifore në proporcion më pjesën e tyre të numrave të konsumatorëve, pik kërkesën koinciduese respektivisht volumet e energjisë (psh. Një qasje e koston së alokuar ose futur). Më shumë detaje mbi qasjen e marrur për llogaritjen e secilës komponentë individuale të ngarkesës janë ofruar në vijim.

Ngarkesat e konsumatorëve/fikse

Ngarkesat e konsumatorëve/fikse llogariten si vijon:

- Ngarkesa e konsumatorit/fikse llogaritet si kosto e alokuar e lidhur me konsumatorin pjestuar nga numri i parashikuar i konsumatorëve në secilën kategori.
- Kostot e lidhura me konsumatorin janë llogaritur si kosto totale e lidhur me konsumatorin e shumëzuar nga pjesa e numrave total të konsumatorëve të secilës kategori.

Shtojca 2: Llogaritja e tarifave në RTM

- Kostot totale të lidhura me konsumatorë janë llogaritur si shumë e margjinës së lejuar të furnizimit dhe kostos me pakicë të furnizimit të KEK-ut që i atribuohet konsumatorëve të rregulluar.

Ngarkesat e kërkesës

Ngarkesat e kërkesës janë llogaritur si vijon për konsumatorët e kategorive 0-3 (konsumatorët më të mëdhenjë industrial dhe komercial):

- Ngarkesa e kërkesës është llogaritur si kostot e alokuara të lidhura me kërkesën pjestuar më shumë e pik kërkesës së parashikuar për kategorinë e konsumatorëve në secilin muaj.
- Kostot e alokuara të lidhura me kërkesën janë llogaritur si kostot totale të lidhura me kapacitetin në secilin nivel të voltazhës të shumëzuar nga pjesa e secilës kategori të konsumatorëve në pik kërkesës koincidente në atë nivel të voltazhës.
- Kostot e kapacitetit total janë llogaritur si shuma e kostos të blerjes me shumicë të energjisë e shumëzuar nga proporcioni i supozuar i kostove të kapacitetit¹⁸ në këto plus ngarkesat infrastrukturale të TUOS rrjetës plus ngarkesat infrastrukturale të DUOS rrjetës shumëzuar me një faktor përshtatës të ndarjes së energjisë/kapacitetit¹⁹.

Për konsumatorët tjerë kostot e alokuara të lidhura me kërkesë janë llogaritur si më sipër. Këto janë atëherë të shtuara të ngarkesat e energjisë siq përshkruhet më sipër.

Ngarkesat e energjisë

Ngarkesat e energjisë për konsumatorët në kategoritë 0-3 (konsumatorët më të mëdhenjë industrial dhe komercial) janë llogaritur si vijon:

- Ngarkesat e energjisë në secilën periudhë (të lartë dimër, të ulët dimër, të lartë verë, të ulët verë) janë llogaritur si kosto të përgjithshme të lidhura me energjinë për tu mbuluar në atë periudhë nga secila kategori e konsumatorëve e pjestuar nga shitjet e parashikuara asaj kategorie konsumatorësh në atë periudhë.

¹⁸ Të përcaktuara të jenë 30% nga KEMA (konsultatët e ZRRE-së për ETR1)

¹⁹ Ky faktor përcakton proporcionin e kostos së distribucionit të lidhur me kërkesën të alokuar në ngarkesën e kërkesës. Është përcaktuar të jetë 100% për kategoritë 1-2 dhe 0% për kategoritë 3-4 (psh. Në të gjitha kostot e distribucionit të lidhura me rrjetin në këto kategori janë alokuar në ngarkesat e energjisë).

Shtojca 2: Llogaritja e tarifave në RTM

- Kostot e lidhura me energjinë për tu mbuluar në secilën periudhë janë llogaritur si kostot totale të lidhur me energjinë në vit, shumëzuar me faktorin e alokimit.
- Faktori I alokimit është llogaritur si:
 - Prodhimi I **kostos marginale afatshkurtër të vlerësuar** (SRMC) në secilën periudhë dhe shitjet e energjisë në atë periudhë në kategorinë e konsumatorit.
 - Prodhimi rezultues pjestohet më të hyrat totale sipas SRMC tarifave (psh. Shuma e prodhimit të SRMC-së në secilën periudhë shumëzohet me shitjet totale të energjisë në secilën periudhë).
- Kostot e lidhura me energjinë janë llogaritur si shuma e koston së lejuar të operatorit të tregut (OT) dhe operatorit të sistemit (OS) të alokuar ndaj konsumatorëve të pa-kualifikuar dhe kostot e përgjithshme të blerjes së energjisë pa atë pjesë të konsideruar që të jetë e lidhur me kërkesën (shih sipër).

Për konsumatorët tjerë, kostot e alokuara të lidhura me kërkesën janë shtuar në ngarkesat e energjisë të llogaritura më sipër. Komponentja e kapacitetit të koston së blerjes së energjisë u është shtuar ngarkesave të energjisë të aplikuara në periudhat e larta (dimrit dhe verës). Komponentja e kapacitetit të ngarkesave të TUOS dhe DUOS iu është shtuar ngarkesave të energjisë të aplikuara në të gjitha periudhat.

Për konsumatorët shtëpiak (kategoria 5-6), dy përshtatje të mëtejme janë bërë²⁰:

- Në mënyrë që të ruhet raporti ekzistues dy me një (vendim I marrur për të rritur pranueshmërinë) mes ngarkesave të periudhave të larta dhe ulëta, ngarkesat e sezonave të larta dhe ulëta janë ri-llogaritur ashtu që raporti mes dy periudhave, në secilën sezonë, mbetet dy me një.
- Një strukturë e trefishtë është pranuar. Tarifat në secilin pjesë (band) janë llogaritur duke përcaktuar ngarkesat e lejuara të energjisë në dy pjesët (bandet) e mëposhtme si përqindje e ngarkesës kosto-reflektive të energjisë (aktualisht të caktuar të jetë 70% për bandazhin e parë dhe 100% për të dytin). Ngarkesat e energjisë për të tretin, më të lartin bandazh atëherë ri-llogariten ashtu që të hyrat totale të mbuluara nga ngarkesat e energjisë për konsumatorët shtëpijak mbesin të pandryshuara.

²⁰ Ekziston gjithashtu një përshtatje tjetër për të konvertuar tarifat rezultuese dy-periudhëshe dhe dy-sezonale në tarifa një-periudhëshe dhe dy-sezonale për konsumatorët me njuhësor një-normësh.

Shtojca 2: Llogaritja e tarifave në RTM

Ngarkesat e energjisë reaktive

Ngarkesat e energjisë reaktive për konsumatorët në kategoritë 1-3 llogariten si:

- Shuma e kostove të alokuara të energjisë reaktive pjestuar me energjinë reaktive totale të matur (në kVARh)
- Kostot e alokuara të energjisë reaktive llogariten si kosto të energjisë reaktive në secilin nivel të voltazhës (këto iu atribuohen tërësisht konsumatorëve që u nënshtroheën ngarkesave të energjisë reaktive).
- Kostot e energjisë reaktive në secilin nivel të voltazhës janë llogaritur si kosto totale të distribucionit të lidhura me voltazhë shumëzuar me pjesën e supozuar të koston të energjisë reaktive në këto²¹.

Një variantë gjithashtu është e lejuar, ku ngarkesa e energjisë reaktive mund të insertohet në menyërë direkte. Kjo është qasja që aplikohet momentalisht.

Llogaritja e TUOS ngarkesave

Ngarkesat e përdorimit të sistemit të transmisionit (TUOS) mbulojnë kostot e KOSTT-it. Ekzistojnë tri ngarkesa të ndryshme:

- Ngarkesa e kapacitetit (infrastrukturës). Kjo mbulon kostot e KOSTT-it për operim, mirëmbajtje dhe investim në rrjetin e transmisionit. Ngarkesa është llogaritur si total i koston të KOSTT-it të lidhur me infrastrukturë pjestuar me pikë kërkesën totale koincidentale në sistemin e transmisionit, për të dhënë një ngarkesë të shprehur në €/kW/vit. Ngarkesa aplikohet vetëm për furnizuesit (psh. Një pjesë/split prej G=0%/L=100%). Konsumatorët prej 100kV paguajnë ngarkesën që aplikohet te ai nivel edhe te niveli 220/400kV. Konsumatorët në nivelin më të lartë të voltazhës paguajnë vetëm në atë ngarkesë që aplikohet në atë nivel.
- Ngarkesa e operatorit të sistemit. Kjo mbulon kostot e KOSTT-it në rolin e tij si OS, përfshirë edhe blerjen e shërbimeve ndihmëse dhe humbjeve. Ngarkesa është llogaritur si kosto totale e lidhur me OS-në pjestuar me shumën e energjisë së parashikuar që hyn në sistemin e

²¹ Kjo pjesë është përcaktuar të jetë 6% për rrjetin 35 kV, 30 % për rrjetin 10kV dhe 2% për rrjetin LV.

Shtojca 2: Llogaritja e tarifave në RTM

transmisionit nga burimet e Kosovës dhe del nga sistemi I transmisionit në të gjitha pikat ²², për të dhënë një ngarkesë të shprehur në €/kWh. Ajo paguhet edhe nga gjeneruesi edhe nga furnizuesit

- Ngarkesa e operatorit të tregut. Kjo mbulon kostot e KOSTT-it në rolin e tij si OT. Ngarkesa llogaritet si kosto totale e lidhur me OT pjestuar me shumën e energjisë së parashikuar që hyn në sistemin e transmisionit nga burimet kosovare dhe del nga sistemi I transmisionit në të gjitha pikat për të dhënë një ngarkesë të shprehur në €/kWh. Ajo paguhet edhe nga gjeneruesi edhe nga furnizuesi.

Llogaritja e DUOS ngarkesave

Këto përmbajnë ngarkesat vijuese:

- Ngarkesën e energjisë. Kjo mbulon kostot e distribucionit të KEK-ut të asociuara me blerjen e humbjeve të distribucionit. Llogaritet si pjesë e këtyre kostove të alokuara në secilën kategori të konsumatorëve pjestuar nga energjia e parashikuar e furnizuar në ata kategori, për të dhënë një ngarkesë të shprehur në €/kWh. Alokimi I kostove është përcaktuar nga një pjesë përkatëse e secilës kategori të konsumatorëve të energjisë që hyn në sistemin e distribucionit (llogaritur duke "rritur bruto" konsumin e matur me humbjet)
- Ngarkesën e energjisë reactive. Kjo mbulon kostot e distribucionit të KEK-ut të ofrimit të energjisë reactive. Llogaritet siq përshkruhet në Seksioni o, sipër.
- Ngarkesa e kërkesës. Kjo mbulon kostot e mbetura të distribucionit të KEK-ut. Llogaritet si të hyrat e bazuara ne koston afatgjatë margjinale totale (LRMC) në secilin nivel të voltazhës pa at pjesë të mbuluar nga ngarkesat e energjisë reactive, pjestuar me pik kërkesën koincidentale të atij niveli për të dhënë një ngarkesë të shprehur në €/kWh/vit. Të hyrat e bazuara në LRMC llogariten si:
 - LRMC-ja e vlerësuar për distribucionin e secilit nivel të voltazhës, e shumëzuar me kërkesën në atë nivel të voltazhës dhe më tutje të shumëzuar nga koeficienti I përshtatjes së të hyravë (për të sjellur të hyrat e LRMC-se në të njejtin nivel me të hyrat e lejuara).

²² Ky definicion siguron që rrjedhat e tranzitit paguajnë ngarkesat e OS vetëm njëherë (gjatë daljes nga sistemi)

Shtojca 2: Llogaritja e tarifave në RTM

- LRMC-ja në secilin nivel të voltazhës është llogaritur si koeficient i LRMC-së në secilin nivel të rritur-bruto nga humbjet margjinale të secilit nivel dhe nga faktori i koincidencës në atë nivel. Këto janë mbledhur ('kaskaduar') për nivelet më të ulëta të voltazhës (psh. LRMC në 10 kV është shuma e koeficientit të LRMC-së së përshtatur në 35 kV dhe 10 kV).
- Koeficienti i LRMC-së në secilin nivel të voltazhës është llogaritur si shumë e kostos operative vjetore dhe të mirëmbajtjes dhe kosto mesatare inkrementale (LRAIC) në secilin nivel të voltazhës.
- LRAIC në secilin nivel të voltazhës është llogaritur si vlerë prezente e investimeve në atë nivel pjestuar me ngarkesën inkrementale të shërbyer, me rezultat vjetor (duke përdorur një jetëgjatësi të supozuar 20 vjeçare dhe koston mesatare të ponderuar të kapitalit).